



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 11 dhjetor 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Shqipe Pantina, Albert Kinolli, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Blerim Kuçi, Ali Lajçi.

Munguan: Faton Topalli, Avdullah Hoti dhe Zafir Berisha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Shkëlqim Xhema, ZKA.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 16.11.2017;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike nr. 06/L-021;
4. Shqyrtimi i planit vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sezonin e auditimit 2017/2018;
5. Diskutim në lidhje me shqyrtimin e raporteve individuale të auditimit;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.11.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.11.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike nr. 06/L-021

Kryetari paraqiti para deputetëve disa argumente se, pse ka lindur nevoja për Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike. Po ashtu, tregoi se KMFP duhet të ketë një grup punues për të analizuar dhe për të përgatitur amendamentet për këtë projektligj. Më tej, theksoi se nevoja për një projektligj të ri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ishte për shkak se Qeveria ka miratuar Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015–2019. Krijimi i kornizës ligjore adekuate për zhvillim të mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, i përbërë nga menaxhimi financiar, kontroll dhe auditim të brendshëm, e paraparë në Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015–2019. Me këtë hapi diskutimin.

Blerim Kuçi, theksoi se për shqyrtimin e këtij projektligji është mirë që të gjithë deputetët të jenë edhe anëtarë të grupit punues.

Ali Lajçi, sido që të vendosë komisioni, unë do të pajtohem me qëndrimin e komisionit. Praktika që të mos jenë të gjithë deputetët anëtarë të grupit, mendoj se është më efikase.

Kryetari theksoi se pasi të miratohet projektligji në parim, në seancë plenare, grupi punues, i përbërë nga Blerim Kuçi, Driton Selmanaj, Shqipe Pantina, Verica Çaraniq dhe Mërgim Lushtaku, do të vazhdojë me punën, për të përgatitur amendamentet për projektligjin.

Përfundim:

KMFP miratoi në parim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike nr. 06/L-021. Po ashtu, KMFP themeloi grupin punues për shqyrtim të projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe komisionit t'i paraqesë raport me rekomandime.

4. Shqyrtimi i planit vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sezonin e auditimit 2017/2018

Kryetari theksoi se ZKA ka përgatitur planin vjetor të punës për sezonin e auditimit 2017/2018. Ky plan i punës mund të ndryshohet, nëse kemi kërkesa, ne si KMFP, për plotësim. Po ashtu, shtoi se kam dy propozime që ZKA të bëjë auditim të kontratës së Qeverisë me KEDS-in, si dhe auditimin e ndarjes së subvencioneve për bujqësinë. Me këtë hapi diskutimin.

Mërgim Lushtaku, përveç kësaj, unë mendoj se kishte me qenë në interes për komisionin që të kërkojë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, që të bëjë auditimin e mënyrës së faturimit të rrymës së shpenzuar në pjesën veriore të vendit. Kjo çështje është ngritur edhe nga Avokati i Popullit.

Shqipe Pantina, theksoi se kishte me qenë mirë që ZKA të bëjë auditim të Fondit për Sigurime Shëndetësore. Për këtë projekt ka pasur buxhet të ndarë dhe ne nuk e dimë se çka është bërë me të, deri tani.

Blerim Kuçi, tha se kërkesa e KMFP për një auditim të Fondit për Sigurime Shëndetësore, që për momentin nuk ekziston, më duket jo e drejtë. Ne mendojmë se më mirë është ta thërrasim ministrin e Shëndetësisë në interpelancë, për këtë, sesa të kërkojmë një auditim në këtë fazë.

Kryetari, tha se ZKA në planin vjetor të auditimit për sezonin e auditimit 2017/2018, duhet të përfshijë edhe dy auditime shtesë, sipas kërkesës së KMFP-së, edhe atë: Zyra Kombëtare e Auditimit në planin vjetor të auditimit, për sezonin e auditimit 2017/2018, përveç tjerash, të përfshijë edhe auditimin e zbatimit të kontratës mes Qeverisë së Kosovës dhe KEDS-it, si dhe Zyra Kombëtare e Auditimit në planin vjetor të auditimit, për sezonin e auditimit 2017/2018, të përfshijë ndarjen e subvencioneve në sektorin e bujqësisë.

Përfundim:

KMFP miratoi planin vjetor të punës së ZKA-së për sezonin e auditimit 2017/2018, me dy kërkesa për auditime shtesë: a) Auditimin e zbatimit të kontratës mes Qeverisë së Kosovës dhe KEDS-it; b) Auditimin e ndarjes së subvencioneve në sektorin e bujqësisë.

5. Diskutim në lidhje me shqyrtimin e raporteve individuale të auditimit

Kryetari paraqiti para deputetëve listën e raporteve të auditimit, të prezantuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, që është në interes për komisionin, për t'i shqyrtuar. Nga 107 raporte, janë përzgjedhur 43 prej tyre, që për secilin deputet do të bien nga 4 raporte. Listën për raporte dhe deputetë e ka përgatitur administrata e komisionit. Për më tepër detaje, e keni materialin e dorëzuar nga administrata e komisionit.

Shqipe Pantina, kërkoi që të bëhen disa ndryshime në renditjen e raporteve, ku në vend të raportit për MTPT-në, kërkoi t'i jepet raporti i MAP-së, dhe në vend të raportit për MMPH-në, kërkoi t'i jepet raporti për KQZ-në.

Kryetari njoftoi deputetët për shqyrtimin e raporteve të auditimit për sezonin e auditimit 2016/2017. Me qëllim që puna e bërë nga deputeti të jetë më e qartë për anëtarët tjerë të komisionit dhe të kontribuojë në efikasitetin e punës së komisionit, atëherë secili deputet, me rastin e shqyrtimit të raportit të auditorit, duhet t'i raportojë komisionit, në formë të shkruar. Raporti duhet të përmbajë: një rekomandim, ku kërkohet që institucioni përkatës duhet të implementojë të gjitha rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit; një rekomandim, ku caktohet afati se kur institucioni duhet të raportojë para komisionit, lidhur me nivelin e

implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit ose edhe nga KMFP. Nëse është e nevojshme, përveç rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, komisioni mund të japë rekomandime shtesë, nëse e sheh të nevojshme. Një rekomandim, i cili tregon se a duhet që raporti të përcillet në seancë plenare apo vetëm t'i dërgohen rekomandimet institucionit përkatës. Në rast se ministrat nuk i përgjigjen ftesës së komisionit, raporti i atij institucioni përcillet në Kuvend, nga ana e komisionit. Pas diskutimeve, u vendos që në mbledhjen e radhës së komisionit të shqyrtohen këto dy raporte: Raporti i auditimit për Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, që do ta prezantojë deputetja Shqipe Pantina dhe raporti i auditimit për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastërtia", Ferizaj, që do ta prezantojë deputetja Verica Çeraniq.

Përfundim:

KMFP miratoi planin e komisionit për shqyrtimin të raporteve të auditimit nga sezoni i auditimit 2016/2017.

6. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se më datë 13.12.2017, Grupi për Studime Juridike ka planifikuar një tryezë, sa i përket Ligjit për financim të subjekteve politike. Në këtë punëtori janë ftuar të gjithë deputetët e KMFP-së. Po ashtu, është diskutuar edhe për punëtorinë e organizuar nga GIZ, ditë më parë, dhe kritikën që i janë dedikuar KMFP-së, për mos-efikasitetin në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të këtij komisioni, të përcaktuara sipas Rregullores së punës së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj